

VENDIM
Nr.203, datë 5.4.2006

**PËR NDRYSHIMIN DHE KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË
OBJEKTEVE REPARTI, KOMANDA, PALESTRA DHE POLIGONI, TË REPARTIT
RENEA, TIRANË, NGA MINISTRIA E BRENDSHME TE MINISTRIA E DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekteve “Komanda e repartit Renea, Tiranë”, me sipërfaqe 450 m² dhe numër rendor 4 “Palestër e repartit Renea, Tiranë”, me sipërfaqe 760 m² e 144 m² dhe numër rendor 5, “Poligon i repartit Renea, Tiranë”, me sipërfaqe 665 m² dhe numër rendor 3, si dhe trualli i objektit “Reparti Renea, Tiranë”, me sipërfaqe 3406 m² dhe numër rendor 1, sipas formularit që i bashkëlidhet vendimit nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit dhe të kalojë nga Ministria e Brendshme te Ministria e Drejtësisë për ndërtimin e mjediseve të Gjykatës së Krimeve të Rënda.

2. Pronat me numër rendor 1, 3, 4 e 5 të hiqen nga lista e inventarit të pronave, që janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Brendshme, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha